



SCANDERBEG

-Associazione Albanese a Parma -

Via Ruggero, 21/A
43100 Parma - PR

Tel: 0521/29.15.83 info@scanderbeg.org
Fax: 0521/04.49.01 www.scanderbeg.org

Banca Popolare dell'Emilia Romagna - Ag.4
CC N°: 1554833 ABI: 05387 CAB: 12701 CIN: Y

Parma 10 Shkurt 2008

Mbeshtetje per "PAVARESINE E KOSOVES"

Të nderuar pjesëmarrës të këtij tubimi !

Sot, shoqata "SKANDERBEG" mblidhet ketu ne Parma per të mbështetur njohjen e pavarsisë së Kosovës heroike!

Siç jemi në dijeni pavarësia e KOSOVES në vitet e fundit u bë një çështje e pa kthyeshme. Me në krye të paharruarin **Dr. Ibrahim Rugova**; në këto vite negociatash, diplomacie, Kosova ka ditur te mbaj gjalle çështjen shqiptare. Kosova shpалosi hapur vendosmërinë e saj duke e mbajtur të palëkundur qëndrimin për pavarësinë.

Një shekull më parë me 1913 traktati famëkeq i Londrës e coptoi Shqipërinë, duke i dhënë pothuaj gjysmën e saj shteteve fqinjë, Çamërinë, Plavën dhe Gucinë, Dibërën dhe Kosovën martire.

Kosovës do ti mohohet liria për gati 100 vjet, duke vuajtur mbi supet e saj poshtërimet, kërcënimet, burgimet dhe vrasjet dhe duke luftuar papushim për lirinë.

Shumë kosovar me familjet e tyre nga pamundësia për të qëndruar në tokën e tyre të shtrenjtë, moren arratinë, ku vendi amë Shqipëria do të bëhej streha e re. Për këtë mjaft patriotë dhe trima luftëtar si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Idriz Seferi, Shote e Azem Galica , me çeta luftëtarësh, bënë të pamundurën për te fituar lirinë.

Gjithashtu edhe gjatë luftës nacionalçlirimtare, mjaft kosovarë dhanë jetën për çlirimin e Kosovës dhe Shqipërisë , si Emin Duraku, Ramiz Varvarica, Asim Vokshi, për të mos harruar Brigadën sulmuese 23 nga Shqipëria e cila mori pjesë për çlirimin e Kosovës ku dhanë jetën shumë deshmorë.

Mbas çlirimit të vendit nga nazi-fashistët, politika antishqiptare, ndoqi një politikë denigruese, duke mos lejuar mbajtjen e flamurit, duke mbyllur shkollat shqipe, duke ndërruar emrat e heronjve dhe duke zevendesuar simbolet kombetare.

Të ndodhur në këtë situatë atdhetaret kosovare, ndonëse te pafuqishm, shpesh ngriheshin në revolta. Këto e detyruan rregjimin të bëje disa lëshime, siç ishte kushtetuta e vitit 1974 ku u njoh Kosova autonome, dhe ngritja e universitetit në

Prishtinë, por gjithsesi të pamjaftueshme. Shpirti lirishtës kosovar i cili vuante nën sundimin antishqiptar shpertheu në revoltë masive në pranverë të vitit 1981.

Ne vitin 1991 u krijua Ushtria Çlirimtare e Kosovës që luftoi me devotshmeri me në krye komandantin legjendar **Adem JASHARI**. Në pranverën e vitit 1999 me në fund Amerika dhe Evropa ndjeu detyrimin të mbeshteste popullin shqiptar duke nderhyer ushtarakisht në KOSOVE.

Në vizitën e tij në Kosovë ditë më parë presidenti i Shqipërisë z. Bamir Topi, deklaroi se në rast embargoje shqiptarët do të ndajnë kafshatën me vëllezrit e tyre kosovar .

Kryeministri Thaçi deklaroi se shpalljen e pavarësisë mund të bëhet me 17 shkurt.

Qeveria kosovare ka konfirmimin e më shumë se 100 shteteve, që do ta njohin pavarësinë e Kosovës.

Evropa, kryesisht Franca, Anglia, Gjermania dhe Italia padrejtësinë e tyre të bërë në fillim të shekullit të kaluar e riparuan në fillim të këtij shekulli.

Rroftë populli Shqiptar nga Kosova në Çamëri !

Rroftë KOSOVA!

Rroftë SHQIPERIA!

Rroftë Bashkimi Evropian dhe Amerika

Rroftë Italia!

Lavdi Deshmoreve!

Durim LIKA

Presidenti i shoqatës